

RAPORTI VJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK, PËR VITIN 2025, REALIZUAR NGA MINISTRI I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR

1. Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë).*

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor ka realizuar në mënyrë të plotë dhe të strukturuar procesin e konsultimit publik për projektligjin “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa”, duke përmbushur kështu detyrimin ligjor që buron nga ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Ky akt është publikuar në “Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik” (RENJKP) në datë 5.11.2024 dhe ka përfunduar më 3.12.2024, ku është ndjekur i gjithë cikli i konsultimit institucional, duke përfshirë hartimin e raportit të konsultimit dhe përmbledhjen e komenteve të marra nga grupet e interesit.

Në këtë kuadër, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor ka siguruar përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të interesit përmes mbledhjes së komenteve të drejtpërdrejta në platformë, organizimit të tryezave të posaçme të diskutimit publik si dhe duke kërkuar mendim në formë shkresore (Universiteti i Tiranës dhe Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë).

Konkretisht janë regjistruar 1,555 vizitorë në platformën RENJKP, një tregues domethënës i interesit dhe përfshirjes qytetare në proces. Një pjesë e konsiderueshme e komenteve të marra janë analizuar dhe reflektuar në versionin final të aktit, duke rritur cilësinë e tij dhe garantuar një produkt legjislativ të ndërtuar mbi parimin e pjesëmarrjes së gjerë dhe dialogut institucional.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Është realizuar procesi i konsultimit publik për 1 akt; projekt ligjin “Për Administrimin e Bashkëpronësisë në Ndërtesat e Banimit” (1,555 shikime në RENJKP).

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Numri i përgjithshëm i projekteve të propozuara prej Ministrit të Shtetit Për Pushtetin Vendor që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik dhe miratuar gjatë vitit 2025, është 1 (një) projekt-ligj.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Është konsultuar i vetmi projektligj, i miratuar, sipas përcaktimeve të pikës 45 të Rregullores së Këshillit të Ministrave, për të cilat hartohen raportet e VNR-së.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Ligji i lartpërmendur i është nënshtruar raportit të VNR-së.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Nga aktet e parashikuara në programin analitik për vitin 2025, për asnjë nuk është përdorur kriteri përjashtues nga konsultimet publike. Natyra e akteve të tjera në Programin analitik ishin VKM dhe jo dokumente strategjike apo ligje.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Struktura e akteve që iu nënshtruan konsultimit publik dhe u miratuan gjatë vitit 2025 përkon me 1 projekt-ligj.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Përmirësimi i situatës lidhet me organizimin e takimeve konsultative që në fazën paraprake të hartimit të projektit, përpara publikimit në RENJKP.

2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe, ishin 4 (katër):

- Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik (RENJKP),
- Tryeza të konsultimit me ekspertë/grupe interesi/teknike,
- I është kërkuar mendim në formë shkresore (Universiteti i Tiranës dhe Unioni i Gjiqtarëve të Shqipërisë),
- Komunikim nëpërmjet postës elektronike.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda e organizimit të tryezave dhe takimeve të konsultimit – kryesisht në format online – ka rezultuar efikase në drejtim të përfshirjes së grupeve të interesit dhe lehtësimit të pjesëmarrjes së tyre në proces.

Vlen të theksohet gjithashtu se është vërejtur një rritje progresive e angazhimit të publikut edhe përmes platformës RENJKP, si në drejtim të numrit të vizitave i cili rezulton të jetë 1,555 vizitorë, ashtu edhe të kontributeve të dorëzuara nga subjektet e interesuara. Paralelisht, mbetet i konsoliduar edhe përdorimi i metodës së komunikimit elektronik përmes adresave zyrtare të postës elektronike, të cilat kanë preferuar të adresojnë sugjerimet e tyre drejtpërdrejt në adresën e personit përgjegjës të kontaktit.

2.2.3.A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, janë organizuar tryeza konsultimi me shoqatën e administratorëve për të marrë mendimet, që në fazën e hershme të hartimit të projektligjit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1.Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Për aktin që i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, është kryer publikimi në RENJKP, duke respektuar afatin ligjor prej minimumi 20 ditë pune.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Përveç afatit në platformë, duke shtuar edhe periudhën e marrjes së mendimeve me shkrim nga aktorë të tjerë, vlerësohet se kohëzgjatja mesatare ishte 4 muaj.

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Ka një gjenerim më të madh të komenteve të ardhura nëpërmjet zhvillimit të takimeve dhe konsultimeve nëpër tryeza publike. Kurse të dhënat e përfituara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se numri i vizitorëve ka qenë tepër i lartë.

Edhe konsultimi përmes formave të tjera të konsultimit (takime online /postë elektronike) ka lejuar pjesëmarrjen e më shumë aktorëve në proces dhe ka rezultuar më i vlefshëm.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1.Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Për vitin 2025 ka pasur një numër të madh të pjesëmarrjes së ekspertëve të fushës apo përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare, konkretisht:

1. Dhoma Amerikane e Tregtisë;
2. Instituti i Kërkimit Urban;
3. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE, prezenca në Shqipëri);
4. Balfin Group (Balkan Finance Investment Group);
5. Co-plan Institute for Habitant Development;
6. Instituti për Bashkitë e Shqipërisë
7. Shoqata e ndërtuesve
8. Shoqata kombëtare e bashkive.

2.4.2. Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

1. Shoqata
2. Kompani biznesi
3. Institute
4. Organizata të huaja që operojnë në Shqipëri

2.4.3. Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

6 palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara:

- Dhoma Amerikane e Tregtisë;
- Instituti i Kërkimit Urban;
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE, prezenca në Shqipëri);
- Balfin Group (Balkan Finance Investment Group);
- Co-plan Institute for Habitant Development;
- Instituti për Bashkitë e Shqipërisë.

2.4.4. Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Nga konsultimi publik i kryer në Regjistrin elektronik, në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, kontributi mbi përmbajtjen e projektligjit konsiston në këto entitete:

1. Dhoma Amerikane e Tregtisë;
2. Instituti i Kërkimit Urban;
3. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE, prezanca në Shqipëri);

4. Balfin Group (Balkan Finance Investment Group);
5. Co-plan Institute for Habitant Development;
6. Universiteti i Tiranës;
7. Instituti për Bashkitë e Shqipërisë;
8. Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë.
9. Asambleja e Bashkëpronarëve (Godina nr.4 Rruga “Zyhri Bajrami” – Fortuzi, Njësia nr. 9, Tiranë
10. Donator ndërkombëtar
11. Shoqëri tregtare

2.4.5. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Zyra e Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1.Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Nga konsultimi përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, nuk ka pasur komente. Komentet jepen kryesisht përmes takimeve (fizike dhe online) me ekspertë të jashtëm.

Numri i komenteve të marra (nga takimet publike dhe me shkrim) janë gjithsej 64.

2.5.2.Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Në total, janë marrë 64 komente, pranuar plotësisht 25, pranuar pjesërisht 27 komente dhe refuzuar 12 komente.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJKP apo takimeve publike, mbetet e kënaqshme, duke theksuar një përmirësim gjatë këtij viti, krahasuar me një vit më parë.

2.5.4.Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Nuk ka patur përditësim të raportit të VNR-së, për projektligjin e konsultuar.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor ka publikuar në RENJKP 1 (një) raport konsultimi për aktin e konsultuar dhe të planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk ka raport të pa publikuar.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

- 1. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)***

Sfidat që lidhen me realizimin efektiv të konsultimit publik mbeten të pranishme edhe gjatë këtij viti, ku elementi më sfidues vazhdon të jetë përfshirja gjithëpërfshirëse dhe aktive e publikut të gjerë në procesin e hartimit të politikave. Megjithatë, vihet re një përmirësim progresiv në nivelin e ndërgjegjësimit qytetar, i reflektuar në rritjen e aksesimeve dhe ndërveprimeve me dokumentet e publikuara në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP). Kjo tregon një perceptim gjithnjë e më të konsoliduar mbi rëndësinë që ka ky mekanizëm si kanal zyrtar për adresimin e opinionëve.

Në këtë kuadër, mbetet thelbësore fuqizimi i kapaciteteve teknike të strukturave përgjegjëse për hartimin e akteve, jo vetëm në aspektin e identifikimit të saktë të grupeve të interesit, por edhe në drejtim të promovimit të një kulture të qëndrueshme bashkëpunimi ndërinstitutional dhe ndërsektorial. Kjo mund të realizohet përmes zhvillimit të trajnimeve të strukturara mbi procesin e konsultimit publik, si dhe përmes ngritjes së instrumenteve të brendshëm monitorues që sigurojnë përfshirjen e qëllimshme dhe efektive të palëve të interesuara. Në këtë mënyrë, jo vetëm rritet cilësia e proceseve të vendimmarrjes, por forcohet edhe besimi qytetar ndaj institucioneve përmes një qasjeje më gjithëpërfshirëse, të hapur dhe të qëndrueshme në hartimin e legjislacionit.